



# Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Rr. "Dervish Hima" Nr.31 Tirana  
Tel & Fax ++ 355 42 40565 / 35249

## INFORMACION

JANAR '99

### 12.01.

Percaktimi I kandidatit per fitimin e burses se Solidaritetit Olimpik duke e pare ne hapesiren e kerkesave te medha qe parashtron aktualiteti I Levizjes Olimpike ishte tema kryesore e mbledhjes se Komisionit Teknik qe u zhvillua ne daten 12.01.

Antaret e ketij Komisioni e trajtuan shfrytezimin e burses ne dy menyra :

\* Bursisti fitues te kryej kualifikimin sportiv prane Institutit Sportiv te specializimit ne Hungari.

\* njekohesisht u parashtrua ideja qe 1-2 specialiste te huaj te thiren ne vendin tone per te organizuar nje kualifikim me nje pjesmarje prej 20-30 vetash.

Ne fund pas nje diskutimi te hollesishem e me votim te hapet u vendos qe kete burse ta fitoje Fed.Basketbollit pasi Fed.Atletikes e perfituar dhe me pare.

### 15.01

Mbledhja e Komisionit Sporti per te Gjithe.

### 15.01

Mbledhja e K A S

### 29.01.

Lidhur me ceshtjen e nje menaxhimi te pergjithshem te bursave pati diskutime te cilat kishin nje qellim te perbashket por ne menyra te ndryshme realizimi.

Si nje detyre imediate doli ngitja e Ekipit Olimpik, duke perfshire te gjithe kandidatet e mundeshem dhe me sportistet qe kane arritur normat minimale kualifikuese dhe mbi bazene kesaj do te behet dhe perkujdesja dhe perkrahja financiare.

- Meqenese KOKSH mundeson Bursen Olimpike eshte pikerisht ky qe duhet te percaktoje dhe "politiken" e tij Olimpike per ne Sidnej 2000 dhe nga ana shtetit te sigurohet mundesia e pjesmarjes ne Kampionatet Boterore dhe Europiane te cilat do te jene kualifikuese per Lojrat Olimpike-u shpreh ne fjalene tij antari I Kryesise se Komitetit Ekzekutiv z.Flamur Reci.

## SHKURT NGA FEDERATAT

### Qitja

Nga data 06.-10.01 ne Luksemburg u zhvillua Takimi Nderkombetar midis qitesve me te mire te Botes.Ne kete aktivitet te rendesishem ekipi shqiptar u perfaqesua me D.Mata dhe E.Shehu ( e cila ne renditjen perfundimtare zuri vendin e peste).

### Atletika



# Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Rr. "Dervish Hima" Nr.31 Tirana  
Tel & Fax ++ 355 42 40565 / 35249

\*Ne nje ceremoni festivo-sportive e cila u organizua per nder te 75 vjetorit te ditelindjes se M M Sportit z. Skender Begeja merr pjese dhe Presidenti I KOKSH z. Arben Jorgoni.

Nga data 11-12 Shkurt 1999 në Stockholm te Suedise u zhvillua Mbledhja e Komisionit Teknik te KO European.

Në këtë Mbledhje asistoi dhe Sek. i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello.

Ndër temat më me interes që u diskutuan ishin : Problemet që janë lidhur me dopingun, Lojrat Rajonale dhe Kontinentale, Maredheniet me FN dhe gjithë çështjeve që I përkasin pjesmarjes së Lojrave Olimpikë si dhe të gjithë çështjeve që I përkasin Solidaritetit Olimpik ne lidhje me pjesmarjen në Lojrat Olimpikë.

Në javën e fundit të shkurtit në praninë e drejtuesve më të lartë të sportit shqiptar Ekipi Olimpik ka marrë "bekimin" zyrtar.

30 sportistë që kanë dalë nga një seleksionim i kujdesshëm i disiplinave sportive më të suksesshme, së bashku me trenerët e tyre do të jenë sfida e Shqipërisë në Sidnej 2000.

Në një ceremoni modeste të zhvilluar në Hotel "Ballkan", kanë përshëndetur Sek. Përgjithshëm I KOKSH, z. Bello, Presidenti I KOKSH Jorgoni dhe z/ministri I sporteve z. Tartari.

Ne fjalën e tyre përshëndetëse zyrtarët e lartë të Olimpizmit theksuan nevojën e përkushtimit maksimal të sportistëve ne Olimpiaden e Sidneit ndërsa z. Tartari premtoi nga organizmat shtetërore dhe një mbështetje të këtyre sportistëve nga ana financiare dhe kushte stërvitore më optimale.

Per te treguar dhe rëndësine që do ti kushtojë shteti Lojrave Olimpikë Sidnei 2000 asistoi në këtë ceremoni promovimi dhe sekretari I presidencës z. Daut Gumeni.

## Nga Komisionet

z. Ilia Gaxho kryetar I Komisionit Sporti per te Gjithe ne mbledhjene tij te radhes duke shtruar ate filozofi konceptimi që shtron Lëvizja Olimpikë tregoi për detyrat imediate që I dilnin ketij komisioni për vitin në vazhdim.

Në përfundim të mbledhjes antarët e ketij komisioni unanimitisht ishin dakord me vendimet që mori ky komision.

\* Si nje kerkese imediate del ngritja e strukturës vullnetare te Komisionit Sporti për te Gjithë ne te gjithë rrethet e Shqipërise.

\* Ne bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit të ngrihet nje Qëndër Masive per te zhvillur te gjithë aktivitet sportive masive.

\* Të organizohet nje Konferencë Kombëtare dhe Sporti për të Gjithë të motivohet si një mjet I fuqishëm Etik, Fizik dhe Estetik.

\*Me nje vendim të Ministrise së Arsimit të përcaktohet Dita Olimpikë.

Ne 22.01 u zhvillua Kampionati Individual Kombetar Dimror me te miret midis pjesmaresve u cilesuan O.Luli,V.Laukaj dhe S.Zoga.

### **Mundje**

Presidenti I Fed.Boterore te Mundjes z.Milan Ercegan shprehet me fjalet me te mira per Sek.e Pergjithshem te FSHM z.Bezhani per pergatitjen e larte profesionale te arbitrave tane zoterinjt Linza dhe Taullai ne Seminarin kualifikues nderkombetar te arbitrarve I cili u zhvillua ne Osja te Italise nga data 15-17 Janar.

### **Peshengritje**

Nga data 16-17.01.ne Kopenhagen u zhvillua Kupa e Danimarkes.  
Peshengritesi yne I talentuar R.Sulkja midis 12 pjesemarsve zuri vendin e I duke ngritur respektivisht 237.5 kg. ne dygaresh.

### **Basketboll**

Kampionati Passerelle  
Faza e pare,date 28-31 1999  
Klasifikimi

#### **Grupi A**

Tirana	10 Pike	5 Fitore	238-157
QMB	9	4	243-135
Teuta	8	3	172-198
Elbasani	7	2	192-181
Q.Skend	6	1	107-193
Ringjallja	3	0	129-215

#### **Grupi B**

Durrresi	10 Pike	5 Fitore	218-159
Tirane	9	4	256-171
Studenti	8	3	238-187
Sonia	7	2	196-208
Gjeneracioni	6	2	133-197
Apollonia	5	0	112-231

Faza e II do te zhvillohet ne Tirane nga data 18-22 Shkurt.

### **Ciklizem**

Fed.Ciklizmit zhvillon Kampionatin Kombetar te Ciklokrosit ku moren pjese ekipet sportive;Tirana,Vllaznija,Apollonija dhe Partizani.

Kjo gare u fitua nga B.Musaji I cili vendosi dhe nje kohe te re me 36!35"duke permisuar kohen e meparshme me 51".



# Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Rr. "Dervish Himza" Nr.31 Tirana  
Tel & Fax ++ 355 42 40565 / 35249

## Mars '99

Lejtmotivi I peshave të ngritura nga peshëngritësi I shquar Aleksandër Kondo endet sërishmi në ambientet tona sportive.

Një mbremje e madhe kulturore Olimpike u organizua në fillim të muajit në mjediset e Tirana International Hotel për të nderuar peshëngritësin e shquar në vite Aleksandër Kondo.

Nderonte me pjesëmarrjen e tij Sek.i Përgjithshëm I K O Hungarez dhe I Fed.Peshengritjes rgjithshëm Botërore Dr.Tamas Ajan.

Ishin gjithashtu të pranishëm drejtues te KOKSH, personalitete të larta shtetërore, sportistë, veteranë, miq dhe të afërt të Aleksander Kondos.

Fjalën e hapjes e mbajti Presidenti I KOKSH ,z.Arben Jorgoni I cili citoi midis të tjerash se ky nuk është thjesht një videoklip I një muzike të lehtë por ai mbart në vetvete të gjitha vlerat kombëtare ,artistike dhe sportive të vendit tonë. Me këtë rast ai falenderon për profesionalizmin e larte autorin e tekstit z.G.Beqiraj, regjisorin E.Teliti, kompozitorin A.Karabashi dhe kengëtarin L.Bulku duke I nderuar dhe me dhenien e "Diplomes OLIMPIKE".

Ndërsa Pr.Tamas Ajan në fjalën e tij përshëndetëse theksoi se ky videoklip me vlerat e tij ideo-emocionale është e natyrshme të bëhet Himn I Federatës Botërore të Peshengritjes. Ai nderon me dhënien e medaljeve Olimpike zotërijve Arben Jorgoni, Stavri Bello, Gudar Beqiraj, dhe Flamur Reçi.

Për të pranishmit u hap dhe ekspozita e pikturës me temë Olimpike nga K.Buza. Me këtë rast për të pranishmit u lexua dhe përshëndetja e Presidentit te KON z.H.A.Samaranç drejtuar ketij piktori .

Marrja me sport është jetë është zhvillim. Larg droges, prostitucionit, kimit dhe ta bejme jetën sa më të gëzueshme dhe larg kotësive të viteve që po përjetojmë - ishte deviza kryesore e Komisionit Femra & Sporti pranë KOKSH.

Dita e Sfides Olimpike në Elbasan - ishte apeli që u nënkuptua nga aktiviteti I zhvilluar në qytetin e Elbasanit .

Sportëdashësit e shumtë që ndoqën garat e aerobise sportive, të tërheqjes së litarit, atletikës , basketbollit dhe volejbollit duartrokitën pjesëmarrjen e ish-sportistëve, mësueset e edukimit fizik dhe veteranet e veprimtarive sportive të rrethit Tiranë, Korçë dhe Elbasan.

Në këtë veprimtari e para në vendin tonë, morën pjesë dhe u përshëndetën nga përfaqësuesi I MKRS, z.Bashkim Milo, dekani I Federates Shumësportese, z.Hysen Domi dhe Krytari I KOR z.Mustafa Shengjini.

Në muajt e ardhëshëm një aktivitet I njejtë do të zhvillohet dhe në rrethe të tjera të vendit.

Për një përshtatje më të mirë me kërkesat bashkohore të informacionit z.Stavri Bello ,Sekretar i Përgjithshëm i KOKSH zhvillon bisedime me Presidentin e Kompanisë me prestigjoze informative Albania Online, z.Robert Mane.

Në bisedimet e sukseshme të tyre u arrit një frymë mirëkuptimi reciprok financiar i ndërsjellte. Asistonte në këto bisedime dhe Drejtori Teknik i kësaj Kompanie z. Ylli Panariti. Së shpejti këto dy institucione do të nënshkruajnë një Protokoll-Mareveshje.

**\* Stavri me Shpresën në Hollandë.**

Me ftesë të COE z.Stavri Bello,Sek.Përgjithshëm dhe znj.Shpres Mati,Shefe e Misionit të Lojrave të Sidneit 2000 marrin pjesë në Takimin e Sekretarve të Përgjithshëm të Europës në Amsterdam të Hollandës 03-05.06  
Rendësia e këtij Seminari konsistone në procedurën dhe rregjistrimin e sportistëve në Lojrat Olimpike.

**\* Stavri i dorëzon Diplomën Olimpikë z.Xhelil Musa.**

Për përkushtimin dhe gatishmërinë e tij për mbështetjen ndaj lëvizjes sportive masive dhe për një përfaqsim denjtoz të Ekipit Kombëtar-ishte ky motivi me të cilin z.Stavri Bello,Sek.i Përgjithshëm i dorëzon z.Xhelil Musa një Diplomë Olimpikë.  
Në ceremoninë protokollare të dorëzimit të dhuratave simbolike,asistente dhe z.Ilia Gaxho,Kryetar i Komisionit,Sporti për të Gjithë.

\*Shoqata "Children's Aid" I jep nje ndihmese me atlete sportive koksh

\*Nderim për ata që kanë kontribuar në sport.

Përsëri në ambientet e Tirana International Hotel KOKSH,

**\* Sesion Shkencor i Akademisë Olimpikë në Olimpia.**

**Fjalët dhe mardhëniet e mira midis njerzeve janë fundamenti i një botë të ardhshme paqësore të cilën po e ëndërojmë të gjithë ne - ishte sentenca e flalës së hapjes të Dr.Konstantinos Georgiadis,Dekan i Akademisë Olimpikë Ndërkombëtare,në Sesionin e i Shkencor të Akademisë Olimpikë Shqiptare, i cili u zhvillua në Olimpia të Greqisë nga 26-29 Qershor.**

Olimpia nuk është vetëm qendra më e madhe arkeologjike e Lojrave të lashta dhe moderne Olimpikë.Në të ndodhen Akademia Olimpikë,Biblioteka me të gjitha volumet e botuara të cilat i përkasin Lojrave dhe Lëvizjes Olimpikë,Muzeu i lashtë dhe modern Olimpik si dhe një fshat Olimpik në të cilin akomodohen të gjithë delegacionet dhe pjemarsit në Sesionet e Akademisë Olimpikë Ndërkombëtare.

Olimpia ka gjithashtu dhe nje kompleks me të gjitha pajisjet e duhura sportive dhe mjaft salla leksionesh ku të rinjtë ,staudentë dhe nxënës të ndryshëm nga Greqia dhe gjithë bota marrin leksione për Olimpizmin si dhe formimin e duhur edukues fizik dhe moral.

Në përbërjen e Delegacionit Olimpik kishte përfaqësues nga KE i KOKSH,Komisioni i Akademisë Olimpikë, MKRS dhe antarë të QKSH të ILKF.

Mbas ekzekutimit të Hymnit Olimpik,Dekani i Akademisë Olimpikë Ndërkombëtare Dr.Konstantinos Georgiadis bën një falenderim të veçantë delegacionit shqiptar dhe një ekspozitë të shkurtër të Lëvizjes Olimpikë Ndërkombëtare.Për të gjithë anatarët e delegacionit të Akademisë Olimpikë nuk ishte aspak e papritur kur Vangjel Zhapa (Evangjelos Zapas) ishte me origjinë shqiptare dhe kishte shpenzuar të gjithë pasurinë e tij për kryerjen me sukses të Lojrave të I Olimpikë të Athinës,1896.

Në emër të delegacionit shqiptar përshendeti Sekretari i Përgjithshëm, z. Stavri Bello, dhe Kryetari i Akademisë Olimpike Shqiptare.

Një vizitë mjaft atentive Delegacioni shqiptar bëri në Muzeun Arkeologjik dhe Modern të Lojrave dhe Lëvizjes Olimpike. Ishtë mjaft emocionuese kur në koldrinin (kazanin) në të cilin ndizet Pishtari Olimpik fokusimi I një poze fotografike. Është pikërisht ky pishtar i cili është ndezur në të gjitha Lojrat Olimpike dhe mbahet nga të gjithë duke kaluar dorë më dorë në të gjithë botën duke inspiruar ndjenjat e Paqes dhe të Miqësisë.

Në bibliotekën mjaft të pasur Olimpike antarët e delegacionit shqiptar gjetën dhe mjaft materiale të vleshme për Lëvizjen Olimpike Shqiptare.

Olimpizmi si një FILOZOFI e lashtë dhe gjithmonë moderne.

E vetnja filozofi e cila e vendos sportin në shërbim të zhvillimit harmonik të njeriut, në pikpamjen për themelimin e një bote paqësore e cila ka si qëllim RUAJTJENE DINJITETIT HUMAN, i ka rezistuar të gjitha kohrave duke "shërbyer" me besnikëri idealeve të Paqes dhe Miqësisë midis popujve- ishte TEMA kryesore e Sesionit të I Shkencor të Akademisë Olimpike Shqiptare në Olimpia '99.

Referuesit znj. L. Markola (Pjer de Kubertin. Një Përpyetje për Edukim), Bardh Misja (Evokimi i vlerave fizike në epikën legjendare shqiptare), Përparim Feruni (Të rrenjosim Olimpizmin) dhe Arben Kacurri (Olimpizmi një sistem vlerash) ngjallën shumë debate dhe polemika të ndryshme. Me një efikasitet të plotë ishin dhe diskutimet e znj. M. Pelinçi, dhe zotërinjve A. Karriqi, A. Shyti, dhe M. Pili.

E vetnja filozofi e cila e vendos sportin në shërbim të zhvillimit harmonik të njeriut, në pikpamjen për themelimin e një bote paqësore e cila ka si qëllim RUAJTJENE DINJITETIT HUMAN, i ka rezistuar të gjitha kohrave duke "shërbyer" me besnikëri idealeve të Paqes dhe Miqësisë midis popujve- ishte TEMA kryesore e Sesionit të I Shkencor të Akademisë Olimpike Shqiptare në Olimpia '99.

\* Dita Olimpike e vrapimit (ne Pogradec)

\* Dita Olimpike (Spiro)